



**K.DH.SH.II.nr.983/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, dhe Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTPSHN “V...” me seli në Viti, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1270/16, të datës 18.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.02.2023, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1270/16, i datës 18.03.2021, vërtetohet.

### **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1270/16 të datës 18.03.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTPSHN “V...” me seli në Viti, Anulohet aktvendimi nr.05.2.1/589/2014 i datës 21.06.2016, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Doganës së Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTPSHN “V...” me seli në Viti, t’ia kthej shumë prej 3,398.40€ (tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e katërdhjetë cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-10695 të datës 03.07.2013, të proceduar në Zyrën Doganore Dheu u Bardhë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës material, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës LKA. Me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës si e bazuar në ligj, Priset aktgjykimi A.nr.1270/16 i datës 18.03.2021 si i pabazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi aktvendimin e kontestuar ose ta kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

## **-Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.05.2.1/589/2014 të datës 21.06.2016, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë NTPSHN “V...” me seli në Viti, për rishqyrtimin e vendimit nr. R-10695 të datës 03.07.2013 të Zyrës Doganore Dheu i Bardhë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit. Me arsyetim se gjykata nga aktvendimi i Doganës së Kosovës 05.2.1/589/2014 i datës 21.06.2016, konstaton se paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit tek e paditura dhe në procedurë ankimore tek sektori i ankesave, për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor ka paraqitur faturën përcjellëse të mallit me nr.002013-061 të datës 28.06.2013, Deklaratën Eksportuese të datës 28.06.2013, Deklaratën e Tranzimit T1 të datës 03.07.2019, Dokumentin e transportit të mallit CMR, por jo edhe urdhërpagesën bankare ndërkombëtare të datës 24.03.2015, mirëpo e paditura përkundër kësaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 72 të KDAK-së dhe nenit 92 të UA nr.11/2009, kur ka dyshuar që vlera e deklaruar e mallit nuk është vlerë reale e paguar është dashur ta njoftoj personin përkatës, në këtë rast paditësin, në formë të shkruar, për bazën e dyshimeve dhe t’i ofroj atij mundësinë në afat kohor të arsyeshëm për përgjigje. Për më tepër e paditura nga paditësi ka mundur që të kërkoj të dhëna shtesë, duke përfshirë edhe urdhërpagesën e mallit lëndor, mirëpo një gjë të tillë nga shkresat e lëndës nuk rezulton ta ketë bërë. Nisur nga ky fakt dhe ajo që gjykata me rastin e zhvillimit të procedurës gjyqësore në këtë konflikt administrativ, herën e parë sipas Aktgjykimit A.nr.1168/13 të datës 16.02.2016, ka administruar si provë edhe urdhërpagesën bankare ndërkombëtare të datës 28.06.2013, e të cilën provë e administroj edhe gjykata në këtë rast, përkundër asaj që paditësi nuk e kishte paraqitur si provë tek e paditura, sepse paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit deklaratës doganore i ka bashkangjitur edhe faturën përcjellëse të mallit me nr.002013-061 të datës 28.06.2013, në vlerë prej 28,500.00€, ashtu siç parashihet me dispozitën ligjore të nenit 123 par.1 pika a) të KDAK-së, ku thuhet se *“Dokumentet në vijim duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lire: a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, për DUD-in me nr.R-10695/03.07.2013 të ZBD Dheu i Bardhë dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore- TVSH në shumë prej 3,398.40€ mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar, detyrime këto të cilat paditësi i ka paguar të paditurës në procedurë të zhdoganimit të mallit me datë 03.07.2013, dhe kjo nuk është kontestuar as nga e paditura gjatë procedurës gjyqësore të zhvilluar në rigjykim.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues, si dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që t'i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës faturën përcjellëse të mallit nr.002013-061 të datës 28.06.2013, transaksionin bankar, i cili është bërë pikërisht për numrin e faturës përcjellëse me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, Deklaratën eksportuese, Deklaratën e tranzitit T1 të datës 03.07.2019, Dokumentin e transportit të mallit CMR, të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në lidhje pretendimin tjetër të paditësit se gjykata thekson se paditësi ka paraqitur tërë dokumentacionin e nevojshëm, si transferi bankar, fatura etj, por nuk thekson se përse nuk është paraqitur kontrata dhe dokumentet tjera të porosisë së mallit nga paditësi në rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se pala paditëse kishte pohuar vet në ankesën e datës 02.09.2013 drejtuar gjykatës se posedon dokumente por Dogana e Kosovës nuk i ka kërkuar asnjëherë, kolegji i kësaj gjykate e pranon si të bazuar arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë se ky pretendim i paditësit nuk ka mbështetje ligjore në legjislacionin doganor të aplikueshëm, sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109 dh as me dispozitat e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor

dhe të Akcizave nuk parashihet që kontrata e shitblerjes është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës Doganore, për vendosje në qarkullim të lirë të mallit të importuar për tu aplikuar metodës e parë e vlerësimit sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së. Ndërsa pretendimi tjetër i të paditurës se gjykata fare nuk i ka administruar provat, e vërteton fakti se gjykata gabimisht konstaton se e paditura nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, pastaj gjykata e mbështet aktgjykimin e vet në kundërshtim me vërejtjet e Gjykatës së Apelit e cila kishte kërkuar që caktimi i shumë së detyrimeve të bëhet përmes ekspertizës financiare edhe përkundër vërejtjeve nuk është bërë, kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar këtë pretendim dhe konstaton se në aktgjykimin e shkallës së parë është dhënë arsytim bindës kur është konstatuar se “në procedurën gjyqësore në rigjykim nuk e caktoj ekspertizën financiare për arsye se i autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimit gjyqësor e dorëzoi si provë DUD-in nr.R-10695 të datës 03.07.2013 të paraqitur nga paditësi në formën fillestare ku rezultojnë detyrimet doganore të deklaruara nga paditësi në vlerë prej 4,800.00€, ndërsa në DUD-in e rivlerësuar këto detyrime janë në vlerë prej 3,398.40€, e cila paraqet shumën e detyrimeve doganore TVSH-së të paguar nga paditësi si rezultat i ri vlerësimit të mallit nga e paditura. Këtë vlerë nuk e kontestoi as i autorizuarin i të paditurës në shqyrtimin gjyqësor të zhvilluar në rigjykim”.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimin i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.983./22, me datë 02.02.2023**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**